- papastërtia C që ka formulë:



(IV)


- papastërtia D që ka formulë:



(V)

dhe

- papastërtia E që ka formulë:



(VI)

ku

sasia e papastërtisë A prezente në cangrelor me pastërti të lartë është më pak se 0,5% sipas peshës, dhe

sasia e papastërtisë B prezente në cangrelor me pastërti të lartë është më pak se 0,2% sipas peshës, dhe

sasia e papastërtisë C prezente në cangrelor me pastërti të lartë është më pak se 0,3% sipas peshës, dhe

sasia e papastërtisë D prezente në cangrelor me pastërti të lartë është më pak se 0,2% sipas peshës, dhe

sasia e papastërtisë E të pranishme në cangrelor me pastërti të lartë është më pak se 0,5% sipas peshës së cangrelor me pastërti të lartë.

2. Formula farmaceutike sipas pretendimit 1, e përbërë nga cangrelor me pastërti të lartë ose të një kripe e tij, si një përbërës aktiv dhe manitol dhe/ose sorbitol si një eksipient i pranuar në farmaci, i përgatitur nga një metodë e përbërë: (a) tretja e cangrelor ose e një kripe të tij në një tretës për të formuar një tretësirë të parë; (b) përzjerja e një agjenti rregullues të pH me tretësirën e parë për të formuar një tretësirë të dytë, ku pH e tretësirës së dytë është midis rreth 8,5 dhe 9,5; dhe (c) heqja e tretësit nga tretësira e dytë për të prodhuar cangrelor me pastërti të lartë ose të një kripë të tij nën kushtet në të cilat arrihet një nivel lagështie më pak se 2,0% sipas peshës, ku eksipienti farmaceutikisht i pranueshëm shtohet në tretësirën e parë, ose në tretësirën e dytë, ose në të dyja, ku përzierja e (b) kryhet nën ndikimin e azotit, ku cangrelor me pastërti të lartë ose kripa e tij ka një total të kombinuar të degraduesve të zgjedhur të hidrolizës dhe oksidimit të cangrelor më pak se rreth 1,0% sipas peshës së cangrelor me pastërti të lartë, dhe ku degraduesit e përzgjedhur të hidrolizës dhe oksidimit janë një ose më shumë anëtarë të përzgjedhur nga grupi që përbëhet nga papastërtia A, papastërtia B, papastërtia C, papastërtia D dhe papastërtia E që kanë përkatësisht formulën (II),

(III), (IV) dhe (VI), siç përcaktohet në pretendimin 1.
3. Formulimi farmaceutik sipas pretendimit 1, i përbërë nga cangrelor me pastërti të lartë ose të një kripe e tij, si një përbërës aktiv dhe manitol dhe/ose sorbitol si një eksipient i pranuar në farmaci, i përgatitur nga një metodë e përbërë nga: (a) tretje e cangrelor ose e një kripe të tij në metanil për të formuar një tretësirë të parë; (b) përzjerja e një agjenti rregullues të pH me tretësirën e parë për të formuar një tretësirë të dytë, ku pH e tretësirës së dytë është midis rreth 8,5 dhe 9,5; dhe (c) heqja e metanolit nga tretësira e dytë për të prodhaur cangrelor me pastërti të lartë ose të një kripe të tij në kusht ku arrihet një nivel lageshtie më pak se 2,0% sipas peshës, ku eksipienti farmaceutikisht i pranueshëm shtohet në tretësirën e parë, ose në tretësirën e dytë, ose në të dyja, ku përzierja e (b) kryhet nën ndikimin e azotit, ku cangrelor me pastërti të lartë ose kripa e tij ka një total të kombinuar të degraduesve të zgjedhur të hidrolizës dhe oksidimit të cangrelor më pak se rreth 1,0% sipas peshës së cangrelor me pastërti të lartë, dhe ku degraduesit e përzgjedhur të hidrolizës dhe oksidimit janë një ose më shumë anëtarë të përzgjedhur nga grupi që përbëhet nga papastërtia A, papastërtia B, papastërtia C, papastërtia D dhe papastërtia E që kanë përkatësisht formulën (II), (III), (IV) dhe (VI), siç përcaktohet në pretendimin 1.
4. Formulimi farmaceutik i pretendimit 1, 2 ose 3, ku heqja e tretësit (c) bëhet nëpërmjet liofilizimit.
5. Formulimi farmaceutik i pretendimit 1 ose 2, duke përfshirë më tej sterilizimin e tretesirës së dytë pas përzjerjes së (b) dhe përpara heqjes së tretësit.
6. Formulimi farmaceutik i pretendimit 1, ku eksipienti farmaceutikisht i pranueshëm është një poliol.
7. Formulimi farmaceutik i pretendimit 1, ku eksipientët farmaceutikisht të pranueshëm janë manitoli dhe sorbitoli.
8. Formulimi farmaceutik i pretendimit 1 ose 2, ku tretësi është me ujë.
9. Formulimi farmaceutik sipas pretendimit 1, 2 ose 3, ku agjenti për rregullimin e pH-së zgjidhet nga grupi i përbërë nga acidi acetik, karbonati i amonit, fosfati i amonit, acidi borik, acidi citrik, acidi laktik, acidi fosforik, citrati i kaliumit, metafosfati i kaliumit, fosfati monobazik i kaliumit, acetati i natriumit, citrati i natriumit, tretësira e laktatit të natriumit, fosfati dibazik i natriumit dhe fosfati monobazik i natriumit, hidroksidi i natriumit, acidi klorhidrik, bikarbonati i natriumit, karbonati i natriumit, bikarbonati i kaliumit, karbonati i kaliumit, hidroksidi i kaliumit, fosfati i kaliumit, fosfati dibazik i kaliumit, fosfati i natriumit dhe borati i natriumit.
10. Formulimi farmaceutik sipas çdonjërit prej pretendimeve 1-9, ku degraduesit e zgjedhur të hidrolizës dhe oksidimit janë papastërtia A, papastërtia B, papastërtia C, papastërtia D dhe papastërtia E që kanë përkatësisht formulën (II), (IV), dhe (VI), siç përcaktohen në pretendimin 1.
11. Një enë e mbyllur që përmban formulën farmaceutike të pretendimit 1 ose 2 nën një gaz të thatë kimikisht inert.
12. Ena e mbyllur sipas pretendimit 11, ku gazi i thatë kimikisht inert është azot ose argon.nit.

---

(11) **13777**
(97) EP4022052//01.07.2026

(96) 20768844.1//28.08.2020
(22) 27.07.2026
(21) AL/P/2026/453
(54) **METODAT PËR PRODHIMIN E ARGINAZËS NJERËZORE TË KOMBINUAR 1 DHE PËRDORIMET E SAJ**
20.10.2026
(30) US US 201962894319 P 30/08/2019
(71) Immedica Pharma AB/Solnavaegen 3H
113 63 Stockholm / SE SE//

(72) Scott W. ROWLINSON/805 Las Cimas Parkway, Suite 100 Austin, Texas 78746 / US,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Një metodë për prodhimin e kombinuar të Arginazës njerëzore të zëvendësuar-me kobalt të pastër, ku Arginaza njerëzore e kombinuar (rhARG) përmban një sekuencë aminoacide që është të paktën 98% identike me SEQ ID NO: 1, metodë që përmban: a. në një bioreaktor, kulturën e qelizave E. coli që prodhojnë rhARG; b. çarjen e qelizave E. coli; c. heqjen e mbetjeve qelizore nga çarja; d. ngarkimin e lëngut qelizor pas çarjes në një kolonë shkëmbimi kationi; e. lëshimin e rhARG me një solucion të lartë kripe; f. inkubimin e rhARG të lëshuar me një kripë kobalti për të formuar rhARG të zëvendësuar-me kobalt (Co-rhARG); g. aplikimin e Co-rhARG të përmendur në një kolonë shkëmbimi anioni dhe mbledhjen e rrjedh-kalimit; h. aplikimin e rrjedh-kalimit në një kolonë të tretë kromatografie; dhe i. lëshimin e Co-rhARG nga kolona e tretë e kromatografisë me një solucion të lartë kripe.
2. Metodë e pretendimit 1, ku deri në 60 gramë rhARG ngarkohet në kolonën shkëmbim kationi për litër rrëshire shkëmbimi kationi.
3. Metodë e pretendimit 1 ose 2, ku lëshimi i rhARG nga kolona shkëmbim kationi përdor një solucion të lartë kripe me përqendrim kripe deri në 0.5 M.
4. Metodë e pretendimit 1 ose 2, ku lëshimi i rhARG nga kolona shkëmbim kationi përdor një solucion të lartë kripe me përqendrim kripe 0.1 M.
5. Metodë e pretendimit 1 ose 2, ku lëshimi i rhARG nga kolona shkëmbim kationi përdor një përbërës me përqendrim kripe nga 0.0 deri në 0.5 M.
6. Metodë e pretendimit 1 ose 2, ku lëshimi i rhARG nga kolona shkëmbim kationi përdor një përbërës me përqendrim kripe nga 0.0 deri në 0.2M.
7. Metodë e çdonjërit prej pretendimeve 1-6, ku kripë kobalti përfshin një kripë Co^{2+}.
8. Metodë e çdonjërit prej pretendimeve 1-7, ku kripë kobalti përmban $CoCl_2$.
9. Metodë e çdonjërit prej pretendimeve 1-8, ku kolona e tretë e kromatografisë përmban një kolonë kromatografie multimodale (MMC).
10. Metodë e çdonjërit prej pretendimeve 1-9, që përmban më tej reagimin e rhARG ose Co-rhARG me një reagent PEGilationi për të siguruar një proteinë PEGilate.
11. Metodë e pretendimit 10, ku proteina PEGilate përmban një ose më shumë mbetje amino acide PEGilate tek K16, K32, K38, K40, K47, K67, K74, K82, L87,

K88, K152, K154, K171, K222, K223, K312 dhe K321.
12. Metodë e pretendimit 11, ku proteina PEGilate që përmban një ose më shumë të 15% deri 60% të K16, 35% deri 80% të K32, 20% deri 85% të K38, 10% deri 60% të K40, 10% deri 60% të K47, 40% deri 90% të K67, 30% deri 95% të K74, 30% deri 98% të K82, 15% deri 65% të K87, 25% deri 70% të K88, 25% deri 85% të K152, 15% deri 65% të K154, 20% deri 75% të K171, 0% deri 30% të K222, 0% deri 35% të K223, 0% deri 45% të K312, dhe 0% deri 45% të K321 është PEGilate.
13. Metodë e çdonjërit prej pretendimeve 10-12, ku proteina PEGilate përmban mbetje amino acide PEGilate të paktën tek K16, K32, K38, K40, K47, K67, K74, K82, L87, K88, K152, K154, K171, K312 dhe K321.
14. Metodë e çdonjërit prej pretendimeve 10-13, ku proteina PEGilate nuk ka mbetje amino acide PEGilate tek K3, K149, K190, K195, K29, K265 dhe K283.
15. Një metodë për prodhimin e kombinuar të Arginazës njerëzore të zëvendësuar me kobalt të pastër, ku Arginaza njerëzore e kombinuar (rhARG) përmban një sekuencë amino acide që është të paktën 98% identike me SEQ ID NO: 1, metodë që përmban: a. në një bioreaktor, kultivimin E. coli që prodhojnë rhARG; b. çarjen e qelizave E. coli; c. heqjen e mbetjeve qelizore nga çarja; d. ngarkimin e lëngur qelizor pas çarjes në një kolonë shkëmbimi kationi; e. lëshimin e rhARG me një solucion të lartë kripe; f. inkubimin e rhARG të lëshuar me 10 mM CoCl2 për të formuar rhARG të zëvendësuar-me kobalt (Co-rhARG); g. aplikimin e Co-rhARG në një kolonë shkëmbimi anioni dhe mbledhjen e rrjedh-kalimit; h. aplikimin e rrjedh-kalimit në një kolonë kromatografie multimodale (MMC); i. lëshimin e Co-rhARG nga kolona MMC me një solucion të lartë kripe; j. shtimi i një teprice thërmijash esteri metoksi PEG sukcinimidil karboksimetil; k. heqja e PEG-ut të tepërt.
16. Një metodë për prodhimin e kombinuar të Arginazës njerëzore të zëvendësuar me kobalt të pastër, ku Arginaza njerëzore e kombinuar (rhARG) përmban një sekuencë amino acide që është të paktën 98% identike me SEQ ID NO: 1, metodë që përmban: a. në një bioreaktor, kultivimin e qelizave E. coli që prodhojnë rhARG në 36°C deri 38°C, dhe pH ndërmjet 7.0 dhe 7.4, me trazim dhe ajrosje; i. rregullimin e temperaturës së bioreaktorit në 29°C; ii. nxitjen e qelizave E. coli të prodhojnë për rhARG; iii. kultivimin e qelizave E. coli për 18 orë; iv. mbledhjen e qelizave E. coli me anë të centrifugimit; b. çarjen e qelizave E. Coli me anë të homogjenizimit me presion të lartë në 25 mM HEPES me një pH ndërmjet 7.2 dhe 7.6, dhe në ose nën 15°C; c. heqjen e mbeturinave qelizore nga çarja me centrifugim në ose nën 15°C, më pas filtrimi i çarjes me një filtër 0.8 mikron dhe më pas filtrimi me një filtër 0.5 mikron; d. ngarkimin e lëngur qelizor pas çarjes në një kolonë shkëmbimi kationi dhe më pas larja e kolonës me 25 mM HEPES, pH 7.2-7.6; e. lëshimin e rhARG në temperaturën e dhomës me një solucion të lartë kripe që përmban 25 mM HEPES, 0.1M NaCl, pH 7.2-7.6; f. inkubimin e rhARG të lëshuar me 10 mM CoCl2 në temperaturën e dhomës për 2 deri 8 orë për të formuar rhARG të zëvendësuar-me kobalt (Co-rhARG); i. shkëmbimi i Co-rhARG në 50mM Tris, pH 8.1-8.5; g. aplikimin e Co-rhARG në një kolonë shkëmbimi anioni dhe mbledhjen e rrjedh-kalimit; h. aplikimi i rrjedh-kalimit në një kolonë kromatografie multimodale (MMC) Capto; i. lëshimin e Co-rhARG nga kolona MMC me një solucion të lartë kripe që përmban 50mM Tris, 250mM NaCl, pH 8.1-8.5.
17. Një metodë për prodhimin e kombinuar të Arginazës njerëzore të zëvendësuar


me kobalt të pastër, ku Arginaza njerëzore e kombinuar (rhARG) përmban një sekuencë amino acide që është të paktën 98% identike me SEQ ID NO: 1, metodë që përmban: a. në një bioreaktor, kultivimin E. coli që prodhojnë rhARG në 36°C deri 38°C, dhe pH ndërmjet 7.0 dhe 7.4, me trazim dhe ajrosje; i. rregullimin e temperaturës së bioreaktorit në 29°C; ii. nxitjen E. coli të prodhojnë për rhARG; iii. kultivimin e E. coli për 18 orë; iv. mbledhjen E. coli me centrifugim; b. çarjen e qelizave E. Coli me homogjenizim me presion të lartë në 25 mM HEPES në një pH prej 7.2 dhe 7.6, dhe në ose nën 15°C; c. heqjen e mbetjeve qelizore nga çarja me centrifugim në ose nën 15°C, më pas filtrimi i çarjes me një filtër 0.8 mikron dhe më pas filtrimi me një filtër 0.5 mikron; d. ngarkimin e lëngut qelizor pas çarjes në një kolonë shkëmbimi kationi më pas larja e kolonës me 25 mM HEPES, pH 7.2-7.6; e. lëshimin e rhARG në temperaturë dhome me një solucion të lartë kripe që përmban 25 mM HEPES, 0.1M NaCl, pH 7.2-7.6; f. inkubimin e rhARG të lëshuar me 10 mM CoCl2 në temperaturë dhome për 2 deri 8 orë për të formuar rhARG të zëvendësuar-me kobalt (Co-rhARG); i. shkëmbimi i Co-rhARG në 50mM Tris, pH 8.1-8.5; g. aplikimi i Co-rhARG në një kolonë shkëmbimi anioni dhe mbledhja e rrjedh-kalimit; h. aplikimi i rrjedh-kalimit në një kolonë kromatografie multimodale (MMC) Capto; i. lëshimin e Co-rhARG nga kolona MMC me një solucion të lartë kripe që përmban 50mM Tris, 250mM NaCl, pH 8.1-8.5 (MMC Përzierje Bazike); i. shkëmbimi i Përzierjes Bazike MMC me 20mM Fosfat Natriumi, 50mM NaCl, 1.5% Glicerol, pH 7.4 (Përzierje Bazike 1), dhe rregullimi i përqendrimit të proteinës në 5.0 mg/mL; ii. shkëmbimi i Përzierjes Bazike 1 me 0.1M fosfat natriumi, pH 8.1-8.5 (Përzierja Bazike 2), dhe përqendrimi i përqendrimit të proteinës në 10.0 mg/mL; j. shtimi i një teprice thërmijash të esterit metoksi PEG sukcinimidil karboksimetil me peshë molekulare të përafërt prej 5,000 Da, ku 19 thermija esteri metoksi PEG sukcinimidil karboksimetil shtohen për çdo thërmijë proteine dhe inkubimi i kësaj përzierje për 30 minuta deri 4 orë me pH afërsisht 8.4; k. heqja e PEG-ut të tepërt duke shkëmbyer Përzierjen Bazike 2 me 20mM Fosfat Natriumi, 50mM NaCl, 1.5% Glicerol, pH 7.4.

---

(11) **13780**
(97) EP4441037//22.07.2026
(96) 22818895.9//28.11.2022
(22) 29.07.2026
(21) AL/P/2026/461
(54) **DERIVATE TË ACIDIT 3-FENIL-1-BENZOTIOFEN-2-KARBOKSILIK SI INHIBITORË TË KINAZËS SË DEHIDROGJENAZËS SË ACIDIT ALFA KETO ME ZINXHIR TË DEGËZUAR PËR TRAJTIMIN E DIABETIT, SËMUNDJEVE TË VESHKAVE, NASH DHE DËSHTIMIT TË ZEMRËS**
21.10.2026
(30) US US202163284797P 01/12/2021, US US202263383562P 14/11/2022
(71) Pfizer Inc./66 Hudson Boulevard East New York, NY 10001-2192 / US US//


(72) Leanne Marie BUZON/Groton, Connecticut 06340 / US,
Kimberly O'Keefe CAMERON/Heights Niantic, Connecticut 06357 / US,
Kevin Francis DEBOYACE/Groton, Connecticut 06340 / US,

Kevin James FILIPSKI/Cambridge, Massachusetts 02139 / US,
David Andrew GRIFFITH/Cambridge, Massachusetts 02139 / US,
Bethany Lyn KORMOS/Cambridge, Massachusetts 02139 / US,
Shenping LIU/Groton, Connecticut 06340 / US,
Luis Angel MARTINEZ ALSINA/Groton, Connecticut 06340 / US,
Matthew Richard REESE/Groton, Connecticut 06340 / US,
Rachel Jane ROTH FLACH/Cambridge, Massachusetts 02139 / US,
Yuan ZHANG/Cambridge, Massachusetts 02139 / US,
(74) Gazmir Isakaj//
MIhal Grameno; Nd. Njësia Administrative Nr. 2; Tiranë 2; 0000; Tiranë, TIRANË, Tiranë
(57) 1.
Një përbërje e Formulës I




Formula I

ku
Z është O ose S;
A është




;

X1 është CR11 ose N;
secila prej X2 dhe X3 janë në mënyrë të pavarur CR11 ose O, ku nëse X2 është O atëherë X3 është CR11; secila prej R1, R3 dhe R4 janë zgjedhur në mënyrë të pavarur nga H dhe fluor;
R2 është H, fluor ose klor;
secila prej R5, R6, R7, R8, R9 dhe R11 janë zgjedhur në mënyrë të pavarur nga H, halo, hidroksil, amino, ciano, (C1 -C4) alkil, (C3-C6) cikloalkil, (C1 -C4) alkoksi, (C1 -C4) fluoroalkil, (C3-C6) fluorocikloalkil, (C1 -C4) fluoroalkoksi, ose (C1 -C4) alkil-(C1 -C4) alkoksi; dhe R10 është H, fluor, klor, ciano, ose (C1 -C4) alkil;
ku kur A është




dhe X1 është CR11, të paktën një prej R1, R2, R3, R4, R5, R6, R7, R10 dhe R11 është halo dhe të paktën një prej R1, R2, R3, R4, R5, R6, R7, R10 dhe R11 është i


ndryshëm nga H;
ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e përbërjes në fjalë.
2.
Përbërja siç përmendet në pretendim1, ku Z është S; A është



; R2 është fluor ose klor; dhe X1 është CR11; ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme.
3. Përbërja siç përmendet në pretendimin 2, ku R1, R3 dhe R4 secila janë H, dhe R2 është fluor; ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme
4. Përbërja siç përmendet në pretendimin 3, ku R5 është fluor, klor, ciano ose (C1 -C4) alkil dhe R10 është H, fluor ose klor; ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme; dhe ku R6 dhe R7 secila janë zgjedhur në mënyrë të pavarur nga H, fluor, klor, ciano, (C1 -C4) alkil, dhe (C1 -C4) alkoksi; ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme.
5. Një përbërje e pretendimit 1, ku përbërja është: acid 6-fluoro-3-(2,4,6-trifluoro-3-metoksifenil) -1-benzotiofen-2-karboksilik; acid 6-fluoro-3-(2,4,5-trifluoro-3-metoksifenil) -1-benzotiofen-2-karboksilik; acid 6-kloro-3-(2,4,5-trifluoro-3-metilfenil) -1-benzotiofen-2-karboksilik; acid 6-kloro-3-(2,4-difluoro-3-metoksifenil) -1-benzotiofen-2-karboksilik; acid 3-(6-kloro-2,4-difluoro-3-metoksifenil) -6-fluoro-1-benzotiofen-2-karboksilik; acid 3-(6-kloro-2,4-difluoro-3-metoksifenil) -6-fluoro-1-benzotiofen-2-karboksilik, ATROP-2; acid 3-(3-kloro-2,4,5-trifluorofenil) -6-fluoro-1-benzotiofen-2-karboksilik; acid 3-(4-kloro-2,6-difluoro-3-metoksifenil) -6-fluoro-1-benzotiofen-2-karboksilik; acid 6-kloro-3-(2,4,6-trifluoro-3-metoksifenil) -1-benzotiofen-2-karboksilik; acid 6-kloro-3-(3-etil-2,4,5-trifluorofenil) -1-benzotiofen-2-karboksilik; ose 3-(3-etil-2,4,5-trifluorofenil) -6-fluoro-1-benzotiofen-2-karboksilat amoni; ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme
6. Një përbërje e pretendimit 1, ku përbërja është: acid 6-fluoro-3-(2,4,5-trifluoro-3-metoksifenil) -1-benzotiofen-2-karboksilik acid; ose acid 3-(6-kloro-2,4-difluoro-3-metoksifenil) -6-fluoro-1-benzotiofen-2-karboksilik, ATROP-2; ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme.
7.
Një përbërje e pretendimit 1, ku përbërja është:




ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme.
8.
Një përbërje e pretendimit 1, ku përbërja është




9.

Një përbërje e pretendimit 1, ku përbërja është:



ose



ose një përzierje e tyre;

ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e përbërjes në fjalë ose përzierje të përbërjeve.


10. Një përbërje e ndonjërit prej pretendimeve 1 deri në 9, ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e përbërjes në fjalë, për përdorim në një metodë trajtimi ose uljeje të rrezikut të shtrimit në spital për sinkopë kardiake, vdekje kardiovaskulare, sinkopë kardiake kongjestive, sinkopë kardiake me simptoma të Klasës I-IV të Shoqatës së Zemrës së Nju Jorkut, sinkopë kardiake me funksion të reduktuar të ventrikulit të majtë (HFrEF), sinkopë kardiake me funksion të ruajtur të ventrikulit të majtë (HF-pEF), sinkopë kardiake me fraksion të nxjerrjes në interval të mesëm (HFmrEF), vdekje kardiovaskulare, sinkopë kardiake te pacientët me diabet mellitus të Tipit II, sëmundje koronare të zemrës, anginë të paqëndrueshme, sëmundje arteriale periferike, sëmundje vaskulare periferike, sëmundje rinovaskulare, hipertension pulmonar, vaskulit, sindroma akute koronare dhe modifikim të rrezikut kardiovaskular, metoda që përfshin administrimin tek një njeri që ka nevojë për një trajtim të tillë të një sasie terapeutikisht efektive të një përbërjeje të ndonjërit prej pretendimeve 1 deri në 13 ose një kripe farmaceutikisht të pranueshme të përbërjes në fjalë.

11. Përbërja për përdorim në një metodë të trajtimit ose uljes së rrezikut të shtrimit në spital, siç përshkruhet në pretendimin 10, ku trajtohet sinkopa kardiake.

12. Një kompozim farmaceutik që përfshin një sasi terapeutikisht efektive të një përbërjeje të ndonjërit prej pretendimeve 1 deri në 9 ose një kripe farmaceutikisht të pranueshme të përbërjes së përmendur dhe një bartës, agjent përhapës ose hollues farmaceutikisht të pranueshëm

13.

Një formë kristalore e një përbërje të pretendimeve 1 deri në 8 që ka strukturën:




ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme.

14. Kristali i pretendimit 13 që ka një model difraksioni të rrezeve-x në pluhur që përfshin vlerat 2-theta prej (rrezatimi CuKα, gjatësi vale prej 1.54056 Å) 7.6 ± 0.2, 14.6 ± 0.2, dhe 27.9 ± 0.2.

15.

Një formë amorfe e një përbërje të pretendimeve 1 deri në 8 që ka strukturën:



ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme.

---

(11) **13753**
(97) EP3700518//13.05.2026
(96) 19864879.2//22.04.2019
(22) 29.07.2026
(21) AL/P/2026/462
(54) **METODA PËR ULJEN E RREZIKUT TË NGJARJEVE KARDIOVASKULARE TEK NJË SUBJEKT ME NJË KOMPOZIM QË PËRMBAN IKOSAPENT ETILI**
12.10.2026
(30) US US201862735670P 24/09/2018, US US201862735680P 24/09/2018, US US201862758387P 09/11/2018, US US201962813888P 05/03/2019, US US201962818514P 14/03/2019
(71) Amarin Pharmaceuticals Ireland Limited/88 Harcourt Street Dublin 2, D02 DK18 / IE IE//

(72) Paresh SONI/148 Long Wharf Drive Mystic, CT 06355 / US,,
(74) Gazmir Isakaj//
MIhal Grameno; Nd. .; ; ; Njësia Administrative Nr. 2; Tiranë 2; 0000; Tiranë, TIRANË, Tiranë
(57) 1. Një kompozim që përmban ikosapent etili (E-EPA), për përdorim në një metodë për të zvogëluar rrezikun e një ose më shumë prej: infarktit të miokardit, goditjes në tru, vdekjes kardiovaskulare, anginës së paqëndrueshme, proçedurave të revaskularizimit koronar dhe/ose shtrimeve në spital për anginë të paqëndrueshme tek një subjekt, metoda përfshin administrimin e përbërjes tek subjekti çdo ditë, ku subjekti është në një regjim statinash me intensitet të lartë që përfshin 40 mg deri në rreth 80 mg në ditë atorvastatinë ose 20 mg deri në 40 mg

në ditë rosuvastatinë, ku subjekti ka i) një nivel bazë të triglicerideve esëll prej 135 mg/dL deri në 500 mg/dL; ose ii) një nivel bazë të triglicerideve esëll prej të paktën 200 mg/dL dhe një nivel bazë të lipoproteinës me dendësi të lartë -C (HDL-C) esëll prej 35 mg/dL ose më pak, ku: subjekti i) ka një sëmundje të konfirmuar kardiovaskulare; ose ii) është 50 vjeç ose më i vjetër, ka diabet mellitus tip I ose tip II dhe të paktën një faktor shtesë rreziku për sëmundje kardiovaskulare të zgjedhur nga: (a) është mashkull 55 vjeç ose më i vjetër ose femër 65 vjeç ose më e vjetër; (b) është duhanpirës ose ka qenë duhanpirës që e ka lënë më pak se 3 muaj më parë; (c) ka hipertension; (d) ka një nivel HDL-C ≤ 40 mg/dL për burrat ose ≤ 50 mg/dL për gratë; (e) ka një nivel hsCRP prej > 3.0 mg/L; (f) ka mosfunksionim renal; (g) ka retinopati; (h) ka mikroalbuminuri; (i) ka makroalbuminuri; dhe/ose (j) ka një indeks kyçi të këmbës-brakial < 0.9 pa simptoma të klaudikacionit intermitent, dhe ku doza ditore e E-EPA është 4g.
2. Kompozimi për përdorim sipas pretendimit 1, ku subjekti është më pak se 65 vjeç.
3. Kompozimi për përdorim sipas cilido pretendimi të mëparshëm, ku subjekti ka një nivel të proteinës reaktive me ndjeshmëri të lartë (hsCRP) prej 2 mg/L ose më pak.
4. Kompozimi për përdorim sipas cilido pretendimi të mëparshëm, ku subjekti ka një nivel bazë të triglicerideve esëll prej 135 mg/dL deri në 500 mg/dL
5. Kompozimi për përdorim sipas cilido pretendimi të mëparshëm, ku kompozimi administrohet për të paktën 2 vjet.

---

(11) **13755**
(97) EP4424709//24.06.2026
(96) 24162872.6//08.05.2020
(22) 30.07.2026
(21) AL/P/2026/465
(54) **REGJIM DOZIMI PËR AGJENTË ANTI-BCMA**
12.10.2026
(30) EP EP 19208417 11/11/2019
(71) Amgen Research (Munich) GmbH/Staffelseestrasse 2
81477 München / DE DE; Amgen Inc./One Amgen Center Drive
Thousand Oaks, CA 91320-1799 / US US//

(72) Julia STIEGLMAIER/81477 Muenchen / DE,
Birgit HUBER/81477 Muenchen / DE,
Alexander MINELLA/Thousand Oaks, 91320 / US,
Vijay UPRETI/Thousand Oaks, 91320 / US,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Një konstrukt antitrupi që përfshin sekuencën e amino acidit siç përshkruhet në SEQ ID NO: 661, për përdorim në trajtimin ose përmirësimin e një neoplazme pozitive BCMA në një subjekt njerëzor, ku neoplazma pozitive BCMA është mieloma multiple e recidivuar dhe/ose rezistente, ku konstrukti i antitrupit është

administruar në një dozë minimale prej 800 µg/ditë në të paktën një cikël, ku një cikël përfshin të paktën tre administrime individuale të konstruktit të antitrupit, ku konstruksioni i antitrupit administrohet në një ose dy hapa dozimi gjatë ciklit të parë, ku një dozë e parë është ndërmjet 800 µg/ditë dhe 1200 µg/ditë, dhe një dozë e fundit (doza e synuar) është ndërmjet 6500 µg/ditë dhe 12 mg/ditë, dhe ku konstruksioni i antitrupit administrohet në mënyrë intravenoze.
2. Konstrukti i antitrupit për përdorim sipas pretendimit 1, ku konstrukti i antitrupit është administruar për 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25 ose më shumë cikle, në mënyrë të preferuar ku konstrukti i antitrupit administrohet gjatë ciklit të dytë dhe në mënyrë opsionale gjatë çdo cikli pasues në doza konstante.
3. Konstrukti i antitrupit për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve të mëparshme, ku një cikël ka rreth 25 deri në rreth 30 ditë, në mënyrë të preferuar rreth 26 ose 27 deri në rreth 29 ditë, dhe më shumë në mënyrë të preferuar rreth 28 ditë.
4. Konstrukti i antitrupit për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve të mëparshme, ku cikli i parë përfshin ose përbëhet prej tre deri në gjashtë administrime individuale, në mënyrë të preferuar katër ose pesë administrime individuale të konstruktit të antitrupit.
5. Konstrukti i antitrupit për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve të mëparshme, ku konstrukti i antitrupit është administruar nëpërmjet injeksionit intravenoz bolus, infuzionit bolus ose infuzionit intravenoz afatshkurtër.
6. Konstrukti i antitrupit për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve të mëparshme, ku konstrukti i antitrupit ka një gjysëm jetë eleminimi (T1/2) prej rreth 3 deri në rreth 14 ditë, rreth 4 deri në rreth 12 ditë, rreth 3 ose 4 deri në rreth 10 ditë, rreth 3 ose 4 deri në rreth 8 ditë, ose rreth 5 deri në rreth 7 ditë.

---

(11) **13779**
(97) EP3538128//01.07.2026
(96) 17870560.4//09.11.2017
(22) 03.08.2026
(21) AL/P/2026/471
(54) **VARIANTET E RECEPTORIT TË AKTIVINËS TIPI IIA DHE METODAT E PËRDORIMIT TË TYRE**
20.10.2026
(30) US US 201662420476 P 10/11/2016, US US 201762531943 P 13/07/2017
(71) Keros Therapeutics, Inc./99 Hayden Avenue
Suite 120 (Bldg. E)
Lexington, MA 02421 / US US//


(72) Jasbir, S. SEEHRA/3 Lincoln Terrace Lexington, MA 02421 / US,
Jennifer LACHEY/99 Tower Road Lincoln, MA 01773 / US,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Një polipeptid që përfshin një variant të receptorit të aktivinës jashtëqelizore

të tipit IIa (ActRIIa), ku varianti ActRIIa ka sekuencën e SEQ ID NO: 69.
2. Polipeptidi i pretendimit 1, ku polipeptidi përfshin më tej një monomer të fushës Fc të shkrirë te C-terminusi i polipeptidit me anë të një lidhësi.
3. Polipeptidi i pretendimit 2, ku lidhësi është një lidhës peptidik që përmban mbetje amino acide fleksibël.
4. Polipeptidi i pretendimit 2 ose 3, ku lidhësi është një ndarës aminoacidesh, ku në mënyrë opsionale ndarësi i amino acideve është GGG.
5. Polipeptidi i çdo njërit prej pretendimeve 2-4, ku fusha Fc është një fusha Fc IgG1.
6. Polipeptidi i pretendimit 5, ku monomeri i fushës Fc përfshin sekuencën amino acide të SEQ ID NO: 97.
7. Një molekulë acidi nukleik që kodon polipeptidin e çdo njërit prej pretendimeve 1-6.
8. Një vektor që përfshin molekulën e acidit nukleik të pretendimit 7.
9. Vektori i pretendimit 8, ku vektori është një vektor viral.
10. Vektori i pretendimit 9, ku vektori viral është një vektor retroviral, një vektor adenoviral, një vektor poxviral, një vektor viral i lidhur me-adeno ose vektor alfaviral.
11. Një qelizë pritëse që shpreh polipeptidin e çdo njërit prej pretendimeve 1 deri në 6, ku qeliza pritëse përfshin molekulën e acidit nukleik të pretendimit 7 ose vektorin e çdo njërit prej pretendimeve 8-10, dhe ku molekula ose vektori i acidit nukleik shprehet në qelizën pritëse.
12. Një metodë in vitro për të bërë polipeptidin e çdo njërit prej pretendimeve 1-6, metoda përfshin: a) sigurimin e një qelize pritëse që përfshin molekulën e acidit nukleik të pretendimit 7 ose vektorin e çdo njërit prej pretendimeve 8 deri në 10; dhe b) shprehjen e molekulës ose vektorit të acidit nukleik në qelizën pritëse në kushte që lejojnë formimin e polipeptidit.
13. Një kompozim farmaceutik që përfshin polipeptidin e çdo njërit prej pretendimeve 1-6, molekulën e acidit nukleik të pretendimit 7, ose vektorin e çdo njërit prej pretendimeve 8-10, dhe një ose më shumë bartës ose eksipientë farmaceutikisht të pranueshëm.

---

(11) **13785**
(97) EP4021507//01.07.2026
(96) 20710490.2//09.03.2020
(22) 04.08.2026
(21) AL/P/2026/472
(54) **DAPAGLIFLOZIN PËR PËRDORIM NË METODA TË TRAJTIMIT TË INSUFICIENCES KARDIAKE ME FRAKSIONE TË REDUKTUARA TË EJEKSIONIT**
22.10.2026
(30) US USP201962893849 30/08/2019, US USP201962930673 05/11/2019, US USP201962946625 11/12/2019, US USP202062960756 14/01/2020, US USP202062969181 03/02/2020, US USP202062985407 05/03/2020
(71) AstraZeneca AB/151 85 Södertälje/SE SE//

(72) Anna, Maria LANGKILDE/SE-151 85 Södertälje SE,
(74) Raimonda Karapici//
NDREKO RINO; Nd. 1; H. 34; Ap. 29; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Dapagliflozina, ose një tretës farmaceutikisht i pranueshëm apo tretës i përzier i saj, për përdorim në uljen e rrezikut të shtrimit në spital për insuficense kardiake ose një vizite mjekësore urgjente për insuficense kardiake te një pacient me insuficense kardiake me fraksion të reduktuar të ejeksionit (HFrEF) dhe pa diabet të tipit 2 (T2D).
2. Dapagliflozina për përdorim sipas pretendimit 1, ku dapagliflozina është në formën e një lënde të ngurtë jo-kristaline ose të një lënde të ngurtë kristaline.
3. Dapagliflozin për përdorim sipas ndonjërit prej pretendimeve të mëparshme, ku pacienti pa diabet të tipit 2 ka një nivel të hemoglobinës së glikuar prej < 6.5%.
4.
Dapagliflozina për përdorim sipas pretendimit 1, ku dapagliflozina është në formën e një solvati (S) -propilen glikol ((S) -PG), i cili ka strukturën:



5. Dapagliflozina për përdorim sipas ndonjërit prej pretendimeve të mëparshme, ku dapagliflozina administrohet tek pacienti në mënyrë orale, në një dozë prej 2.5 mg, 5.0 mg ose 10 mg, një herë në ditë.
6. Dapagliflozin për përdorim sipas ndonjërit prej pretendimeve të mëparshme, ku përdorimi është tek një pacient që merr një ose më shumë agjentë të kujdesit standard për dështimin e zemrës (HF) për të trajtuar HF para ose gjatë administrimit të agjentëve të dështimit të zemrës (HF.
7. Dapagliflozin për përdorim sipas pretendimit 6, ku një ose më shumë agjentë HF të kujdesit standard janë zgjedhur nga grupi që përbëhet nga frenuesit e enzimës konvertuese të angiotenzinës (ACE), bllokuesit e receptorëve të angiotenzinës II (ARB), bllokuesit beta, antagonistët e receptorëve të mineralokortikoideve (MRA), frenuesit e neprilizinës dhe diuretikët.
8. Dapagliflozin për përdorim sipas ndonjërit prej pretendimeve të mëparshme, ku përdorimi rezulton në një ulje të shtrimeve në spital të përsëritura për insuficiencë kardiake (IK) ose një ulje të ngjarjeve të përsëritura të IK-së.
9. Dapagliflozin për përdorim sipas pretendimit 8, ku ngjarjet e përsëritura të IK-së përfshijnë një shtrim në spital për IK ose një vizitë urgjente mjekësore për IK-në.
10. Dapagliflozin për përdorim sipas ndonjërit prej pretendimeve 1 deri në 7, ku përdorimi çon në një incidencë më të ulët të vdekjeve për shkak të shkaqeve jo-kardiovaskulare.
11. Dapagliflozin për përdorim sipas pretendimit 6, ku përdorimi zvogëlon shkallën e një pike primare kryesore të përbërë të vdekjes kardiovaskulare, shtrimit në spital për shkak të dështimit të zemrës (IK) ose një vizite urgjente mjekësore për IK, tek

një pacient me IKfrEF që trajtohet me një frenues SGLT2 dhe agjentë standardë të kujdesit IK, ku shkalla zvogëlohet në krahasim me një pacient që trajtohet vetëm me agjentë standardë të kujdesit IK.
12. Dapagliflozin për përdorim sipas pretendimit 6, ku përdorimi zvogëlon shkallën e një pike sekondare të përbërë të vdekjes kardiovaskulare ose shtrimit në spital për shkak të dështimit të zemrës (HF), tek një pacient me HFrEF që trajtohet me një frenues SGLT2 dhe medikamente standarde të kujdesit për HF, ku shkalla zvogëlohet në krahasim me një pacient që trajtohet vetëm me agjentë standard të kujdesit për HF.

---

(11) **13730**
(97) EP4512473//24.06.2026
(96) 24205125.8//03.08.2018
(22) 04.08.2026
(21) AL/P/2026/475
(54) **VAFIDEMSTAT PËR TRAJTIMIN E NDRYSHIMEVE NË SJELLJE.**
07.10.2026
(30) EP EP 17382544 03/08/2017, EP EP 17382544 03/08/2017
(71) Oryzon Genomics, S.A./Carrera de San Jerónimo 15, 2a planta
28014 Madrid / ES ES//

(72) Tamara MAES/08940 Cornellà de Llobregat / ES,
David ROTLLANT POZO/08940 Cornellà de Llobregat / ES,
Christian GRIÑÁN FERRE/08940 Cornellà de Llobregat / ES,
Mercè PALLÀS LLIBERIA/08940 Cornellà de Llobregat / ES,
Roser NADAL ALEMANY/08940 Cornellà de Llobregat / ES,
Antonio ARMARIO GARCÍA/08940 Cornellà de Llobregat / ES,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Një frenues KDM1A i cili është 5-((((1R,2S) -2-(4 (benziloksi) fenil) ciklopropil) amino) metil) -1,3,4-okdadiazol-2-amine, ose një kripë ose tretësirë e saj farmaceutikisht e pranueshme, për përdorim në trajtimin e një ndryshimi në sjellje, ku ndryshimi në sjellje është tërheqje sociale ose agresivitet, ku tërheqja sociale ose agresiviteti shoqërohet me një sëmundje.
2. Një kompozim farmaceutik për përdorim në trajtimin e një ndryshimi në sjellje, ku ndryshimi në sjellje është tërheqje sociale ose agresivitet, ku tërheqja sociale ose agresiviteti shoqërohet me një sëmundje, dhe ku kompozimi farmaceutik përfshin një frenues KDM1A i cili është 5-((((1R,2S) -2-(4-(benziloksi) fenil) ciklopropil) amino) metil) -1,3,4-oksadiazol-2-amine, ose një kripë ose tretësirë e saj farmaceutikisht e pranueshme, dhe një ose më shumë eksipientë ose bartës farmaceutikisht të pranueshëm.
3. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 1 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 2, ku ndryshimi i sjelljes është tërheqja sociale e shoqëruar me një sëmundje.
4. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 1 ose kompozimi farmaceutik për

përdorim sipas pretendimit 2, ku ndryshimi i sjelljes është agresivitet i shoqëruar me një sëmundje.
5. Përbërja për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve 1, 3 ose 4 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve 2 deri në 4, ku sëmundja është një sëmundje e CNS.
6. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 3 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 3, ku sëmundja është çrregullim i spektrit të autizmit, skizofreni, një çrregullim i humorit ose çrregullim i stresit post-traumatik.
7. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 3 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 3, ku sëmundja është çrregullim i spektrit të autizmit.
8. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 3 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 3, ku sëmundja është skizofrenia.
9. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 3 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 3, ku sëmundja është çrregullimi i stresit post-traumatik.
10. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 4 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 4, ku sëmundja është çrregullim kufitar i personalitetit, çrregullim i spektrit të autizmit, çrregullim i mungesës së vëmendjes dhe hiperaktivitetit tek të rriturit, sëmundja e Alzheimerit, sëmundja e Parkinsonit, skizofrenia ose një çrregullim i lidhur me stresin.
11. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 4 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 4, ku sëmundja është çrregullim kufitar i personalitetit.
12. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 4 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 4, ku sëmundja është çrregullim i spektrit të autizmit.
13. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 4 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 4, ku sëmundja është sëmundja e Alzheimerit.
14. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 4 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 4, ku sëmundja është skizofrenia.
15. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 4 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 4, ku sëmundja është një çrregullim i lidhur me stresin.
16. Përbërja për përdorim sipas pretendimit 15 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas pretendimit 15, ku çrregullimi i lidhur me stresin është çrregullimi i stresit post-traumatik.
17. Përbërja për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 ose 3 deri në 16 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve 2 deri në 16, ku pacienti që do të trajtohet është një njeri.
18. Përbërja për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 ose 3 deri në 17 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve 2 deri në 17, ku frenuesi KDM1A është 5-((((1R,2S) -2-(4-(benziloksi) fenil) ciklopropil) amino) metil) -1,3,4-oksadiazol-2-amine.
19. Përbërja për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve 1 ose 3 deri në 18 ose kompozimi farmaceutik për përdorim sipas çdo njërit prej pretendimeve 2 deri në 18, ku frenuesi KDM1A ose kompozimi farmaceutik administrohet në mënyrë orale.

---

(11) **13757**
(97) EP4590899//24.06.2026
(96) 24704897.8//11.01.2024

(22) 06.08.2026
(21) AL/P/2026/480
(54) **RRJETË MBROJTËSE PËR PUNIME CIVILE ME TELA METALIKE ME REZISTENCË TË LARTË ME NJË SHTRESË MBROJTËSE**
12.10.2026
(30) IT IT20230000357 12/01/2023
(71) Officine Maccaferri S.p.A./Via Albricci Alberico, 9, 20122 Milano (MI) / IT IT//

(72) Antoine GAGLIARDI/40126 Bologna (BO) / IT,
(74) Vladimir Nika//
Rruga Fadil Rada, Pallati Gener 2, Shkalla C, Nr 2/1, Tirane
(57) 1. Rrjetë mbrojtëse (10) për punime civile, që përfshin tela metalikë (16) që kanë rezistencë të lartë dhe që kanë një shtresë plastike mbrojtëse (18), ku rrjeta është e tipit me përdredhje të dyfishtë (14) ose me përdredhje të trefishtë me vrima gjashtëkëndore, e karakterizuar në atë që telat janë tela çeliku me një rezistencë në tërheqje midis 600 dhe 1350 MPa.
2. Rrjetë mbrojtëse sipas pretendimit të mëparshëm, ku telat e çelikut kanë një rezistencë në tërheqje në rangun nga 600 deri në 1000 MPa, mundësisht në rangun nga 600 deri në 800 MPa.
3. Rrjetë mbrojtëse sipas çdo njërit prej pretendimeve të mëparshme, ku veshja plastike (18) ka një trashësi në rangun midis 0.3 mm dhe 0.6 mm dhe mundësisht midis 0.5 mm dhe 0.55 mm.
4. Rrjetë mbrojtëse sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku teli metalik (16) ka një diametër më të vogël se 4 mm dhe mundësisht më të vogël se 3 mm.
5. Rrjetë mbrojtëse sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku veshja plastike (18) është një veshje e zgjedhur nga PE, PVC dhe PA.
6. Rrjetë mbrojtëse sipas secilit prej pretendimeve të mëparshme, ku veshja plastike mbrojtëse (18) përfshin të paktën dy shtresa polimerësh që kanë karakteristika të ndryshme nga njëra-tjetra.
7. Rrjetë mbrojtëse sipas pretendimit 6, ku veshja mbrojtëse plastike (18) përfshin një shtresë të parë polimeri më të brendshme që mbulon drejtpërdrejt telin metalik (16) dhe ka një trashësi të parë dhe një shtresë të dytë polimeri më të jashtme që mbulon shtresën e parë prej polimeri dhe ka një trashësi të dytë që është më e madhe se trashësia e parë e shtresës së parë prej polimeri.
8. Metodë për prodhimin e një rrjete mbrojtëse sipas çdo njërit prej pretendimeve të mëparshme, që përfshin hapat: - pajisjes së një numri telash metalikë (16) me një shtresë plastike mbrojtëse (18), ku telat kanë një rezistencë në tërheqje midis 600 dhe 1350 MPa; - thurjen e telave metalikë të veshur (16) me njëri-tjetrin, duke prodhuar një rrjetë (10) me vrima gjashtëkëndore me pjesë të ndërthurura midis telave me përdredhje të dyfishtë ose të trefishtë (14).
9. Metodë sipas pretendimit 8, ku telat metalikë (16) janë të veshur me një material plastik (18) i cili përfshihet në grupin e PE, PVC dhe PA.
10. Metodë sipas pretendimit 9, ku telat metalikë (16) janë të veshur me PE.
11. Metodë sipas çdonjërit prej pretendimeve 8 deri në 10, ku veshja mbrojtëse plastike (18) përfshin të paktën dy shtresa polimerësh që kanë karakteristika të ndryshme nga njëra-tjetra.
12. Metodë sipas pretendimit 11, ku përdoret një proces bashkë-ekstrudimi për të

veshur telin me të paktën dy shtresa polimerësh.
13. Metodë sipas pretendimit 11 ose pretendimit 12, ku një shtresë e parë, më e brendshme dhe më e hollë polimeri është bërë nga një polimer PE që përfshin aditivë që nxisin ngjitjen e tij në tela (16), ku një shtresë e dytë, më e jashtme dhe më e trashë polimeri është bërë nga një polimer HDPE.
14. Metodë sipas çdonjërit prej pretendimeve 8 deri në 13, ku përmirësohet ngjitja e veshjes plastike (18) në telin metalik (16) me anë të një teknike ose një kombinimi teknikash që zgjidhet nga grupi i pëbërë nga: procese termike në tel, për shembull, me telin që ngrohet para ekstrudimit; një rritje e sipërfaqes së kontaktit me anë të nyjëzimit të saj ose sistemeve të tjera; kontrollimi i metodës për ftohjen e materialit plastik; përmirësimi i presionit të aplikimit të materialit plastik në mbështetëse; përdorimi i astareve/agjentëve lidhës të llojeve të ndryshme, si para ekstrudimit ashtu edhe gjatë ekstrudimit, si në gjendje të nxehtë ashtu edhe në gjendje të ftohtë; pastrimi i telit; një process ekstrudimi me lidhje me shkrirje ose me lidhje termike.

---

(11) **13734**
(97) EP4096703//17.06.2026
(96) 21748068.0//22.01.2021
(22) 10.08.2026
(21) AL/P/2026/485
(54) **TIRZEPATIDE PËR PËRDORIM KUNDËR PAMJAFTUESHMËRISE KARDIAKE ME FRAKSION TË RUAJTUR TË EJEKSIONIT**
08.10.2026
(30) US 202062967867 P 30/01/2020
(71) ELI LILLY AND COMPANY /Lilly Corporate Center Indianapolis, IN 46206-6288 / US US//

(72) Matthew Paul COGHLAN /c/o Eli Lilly and Company P.O. Box 6288 Indianapolis, Indiana 46206-6288 / US,
Axel HAUPT/c/o Eli Lilly and Company P.O. Box 6288 Indianapolis, Indiana 46206-6288 / US,
Masahiro MURAKAMI/c/o Eli Lilly and Company P.O. Box 6288 Indianapolis, Indiana 46206-6288 / US,
Jeffrey Scott RIESMEYER/c/o Eli Lilly and Company P.O. Box 6288 Indianapolis, Indiana 46206-6288 / US,
(74) Ela Panidha//
Zhan D'Ark; Nd. 2; H. 3; Ap. 15; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia bashkiake nr. 10; 1001; Tiranë, TIRANË, Tiranë
(57) 1. Tirzepatide, ose një kripë farmaceutikisht e pranueshme e saj, për përdorim në trajtimin, parandalimin ose vonimin e zhvillimit të Pamjaftueshmërise Kardiake me fraksion të ruajtur të ejeksionit tek një pacient, ku një sasi efektive e tirzepatides, ose një kripe farmaceutikisht e pranueshme e saj, i administrohet pacientit një herë në javë.
2. Tirzepatide, ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme, për përdorim sipas pretendimit 1 ku pacienti ka diabet mellitus të tipit 2.

3. Tirzepatide, ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme, për përdorim sipas pretendimit 1 ose pretendimit 2 ku pesha e pacientit është obeze.
4. Tirzepatide, ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme, për përdorim sipas pretendimit 1 ose pretendimit 2 ku pesha e pacientit nuk është obeze.
5. Tirzepatide, ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme, për përdorim sipas ndonjërit prej pretendimeve 1 deri në 4, ku administrimi i tirzepatides, ose një kripe të saj farmaceutikisht të pranueshme, siguron një rrezik të reduktuar të shtrimit në spital për HFpEF.
6. Tirzepatide, ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme, për përdorim sipas ndonjërit prej pretendimeve 1 deri në 5, ku administrimi i tirzepatides, ose një kripe të saj farmaceutikisht të pranueshme, rezulton në një ulje të rrezikut të vdekjes nga HFpEF.
7. Tirzepatide, ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme, për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 6 ku testi i ecjes gjashtë minutëshe të pacientit përmirësohet me rreth 10%.
8. Tirzepatide, ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme, për përdorim sipas ndonjërit prej pretendimeve 1 deri në 7, ku rreziku i pacientit për shfaqjen e një kombinimi të rezultateve të mëposhtme është zvogëluar: shtrimi në spital për HFpEF, ose vdekja.
9. Tirzepatide, ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme, për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 8, ku sasia efektive e tirzepatides, ose një kripe të saj farmaceutikisht të pranueshme, e administruar zgjidhet nga rreth 5,0 mg, rreth 10,0 mg dhe rreth 15,0 mg.
10. Tirzepatide, ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme, për përdorim sipas pretendimit 9, ku sasia efektive e tirzepatides, ose një kripe të saj farmaceutikisht të pranueshme, e administruar është rreth 15,0 mg.
11. Tirzepatide, ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme, për përdorim sipas ndonjërit prej pretendimeve 1 deri në 10, ku administrimi një herë në javë i tirzepatides, ose një kripe të saj farmaceutikisht të pranueshme, vazhdon për të paktën 2 vite.
12. Tirzepatide, ose një kripë e saj farmaceutikisht e pranueshme, për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 8, ku pacienti ka ose: faktorë të shumtë rreziku kardiovaskular pa sëmundje kardiovaskulare të përcaktuar; ose sëmundje kardiovaskulare të përcaktuar.

---

(11) **13736**
(97) EP4438126//17.06.2026
(96) 24194760.5//30.04.2018
(22) 10.08.2026
(21) AL/P/2026/486
(54) **APALUTAMIDI, PËR PËRDORIM NË TRAJTIMIN E KANCERIT TË PROSTATËS REZISTENT NDAJ KASTRIMIT JO-METASTATIK**
08.10.2026
(30) US US 201762572791 P 16/10/2017, US US 201862617745 P 16/01/2018, US US 201862630594 P 14/02/2018
(71) Aragon Pharmaceuticals, Inc./800/850 Ridgeview Drive

Horsham, PA 19044 / US US//

(72) Arturo MOLINA/Los Altos, 94024 / US,
(74) Krenar Loloçi//
ZEF JUBANI; Nd. 15; H. 15; Ap. 26; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 5; NJËSIA BASHKIAKE NR. 5; 1019; TIRANË, TIRANË, TIRANË
(57) 1. Apalutamidi për përdorim në një metodë për të përmirësuar mbijetesën e përgjithshme të një subjekti njerëzor mashkull me kancer të prostatës rezistent ndaj kastrimit jo-metastatik (NM-CRPC), ku metoda përfshin administrimin e apalutamidit në kombinim me terapinë e privimit nga androgjenet (ADT) te një subjekt mashkull njerëzor, dhe ku përmirësimi është në varësi të administrimit të një placebo në kombinim me ADT.
2. Apalutamidi për përdorim sipas pretendimit 1, ku metoda përfshin përmirësimin e mbijetesës së përgjithshme mesatare të një popullate subjektesh meshkuj njerëzorë me NM-CRPC duke administruar apalutamidin te këto subjekte meshkujsh njerëzor në kombinim me ADT, ku një përmirësim i tillë është në varësi të mbijetesës mesatare të përgjithshme të një popullate subjektesh meshkuj njerëzorë me NM-CRPC të trajtuar me placebo në kombinim me ADT.
3. Apalutamidi për përdorim sipas pretendimit 1, ku përmirësimi është në varësi të mbijetesës së përgjithshme mesatare të një popullate subjektesh meshkuj njerëzorë me NM-CRPC të trajtuar me placebo në kombinim me ADT.
4. Apalutamidi për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 3, ku administrimi i apalutamidit rezulton në një aktivitet anti-tumoral të përmirësuar, i matur në varësi të mbijetesës së përgjithshme dhe kohës deri në fillimin e kimioterapisë citotoksike, ku ky përmirësim është në varësi të administrimit të një placebo në kombinim me ADT.
5. Apalutamidi për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 1 deri në 4, ku metoda përfshin më tej përmirësimin e kohës deri te avancimi simptomatik te një subjekt mashkull njerëzor, ku ky përmirësim në kohën e avancimit simptomatit është në varësi të administrimit të një placebo në kombinim me ADT.
6. Apalutamidi për përdorim në një metodë për përmirësimin e kohës së avancimit simptomatik te një subjekt mashkull njerëzor me kancer të prostatës rezistent ndaj kastrimit jo-metastatik (NM-CRPC), ku metoda përfshin administrimin e apalutamidit në kombinim me terapinë e privimit nga androgjenet (ADT) te një subjekt mashkull njerëzor, dhe ku përmirësimi është në varësi të administrimit të një placebo në kombinim me ADT.
7. Apalutamidi për përdorim sipas pretendimit 6, ku metoda përfshin avancimin e mbijetesës së përgjithshme mesatare të një popullate subjektesh meshkuj njerëzorë me NM-CRPC duke administruar apalutamidin te këto subjekte meshkujsh njerëzorë në kombinim me ADT, ku një përmirësim i tillë është në varësi të kohës mesatare deri te avancimi i simptomave në një popullatë subjektesh meshkuj njerëzorë me NM-CRPC të trajtuar me placebo në kombinim me ADT.
8. Apalutamidi për përdorim sipas pretendimit 6, ku përmirësimi është në varësi të kohës mesatare deri te avancimi i simptomave në një popullatë subjektesh meshkuj njerëzorë me NM-CRPC të trajtuar me placebo në kombinim me ADT.
9. Apalutamidi për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve 6 deri në 8, ku

administrimi i apalutamidit rezulton në një aktivitet anti-tumoral të përmirësuar, i matur në varësi të kohës mesatare deri te avancimi i simptomave dhe kohës deri në fillimin e kimioterapisë citotoksike, ku përmirësimi është në varësi të administrimit të një placebo në kombinim me ADT.
10. Apalutamidi për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve pararendëse, ku NM-CRPC është NM-CRPC me rrezik të lartë.
11. Apalutamidi për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve pararendëse, ku (secili prej) subjekti mashkull njerëzor(ë) ka një kohë dyfishimi të antigjenit specifik të prostatës (PSADT) prej 10 muajsh ose më pak.
12. Apalutamidi për përdorim sipas çdonjërit prej pretendimeve pararendëse, ku apalutamidi administrohet nga goja në një dozë prej rreth 240 mg në ditë.
